

# **Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësve**

(Ndryshme të SNK 19)

## Ndryshime të SNK 19 Përfitimet e punonjësve

Paragrafët 93-94 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 175. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Paragrafi 92 është shtuar vetëm për referencë.

### Hipotezat aktuariale: pagat, përfitimet dhe kostot mjekësore

- ...
- 92 Disa skema të përfitimeve të përcaktuara kërkojnë nga punonjësit ose nga palët e treta të kontribuojnë në koston e skemës. Kontributet e punonjësve ulin koston e përfitimit për njësinë ekonomike. Një njësi ekonomike merr në konsideratë nëse kontributet e palëve të treta e ulin koston e përfitimeve të njësisë ekonomike, apo janë një e drejtë për t'iu rimbursuar siç përshkruhet në paragrafin 116. Kontributet nga punonjësit ose nga palët e treta ose janë të përcaktuara në termat formalë të skemës (ose dalin si detyrime konstruktive që shkojnë përtej këtyre termave) ose janë lënë të papërcaktuara. Kontributet e papërcaktuara nga punonjësit ose nga palët e treta e ulin koston e shërbimit në momentin e pagesës së këtyre kontributeve në skemë.
- 93 Kontributet nga punonjësit apo nga palët e treta të përcaktuara në termat formalë të skemës ose e ulin koston e shërbimit (nëse ato janë të lidhura me shërbimin), ose ~~ul~~ulindikojnë rimatjet e pasivit (aktivitet) neto të përfitimeve të përcaktuara (në qoftë se ato nuk janë të lidhura me shërbimin). Një shembull i kontributeve që nuk janë të lidhura me shërbimin është kur ~~(për shembull në qoftë se~~ kontributet kërkohej të ulin një deficit që rrjedh nga humbjet në aktivet e skemës ose nga humbjet aktuariale). Në qoftë se k~~K~~ontributet nga punonjësit ose palët e treta janë të lidhura ~~me~~me shërbimin, këto kontribute e ulin koston e shërbimit si më poshtë: ~~i atribuohen shpenzimeve të periudhës si një përfitim negativ në përputhje me paragrafin 70 (që thotë përfitimi neto atribuohet në përputhje me këtë paragraf).~~
- (a) në qoftë se shumica e kontributeve varet nga numri i viteve të shërbimit, një njësi ekonomike duhet të atribuojë kontributet në periudhat e shërbimit duke përdorur të njëjtën metodë atribimi që kërkon paragrafi 70 për përfitimin bruto (që do të thotë ose të përdorë formulën e kontributeve të skemës ose mbi bazën lineare); ose
- (b) në qoftë se shumica e kontributit është e pavarur nga vitet e shërbimit, njësisë ekonomike i lejohej të njohë këto kontribute si një ulje të koston të shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi ne fjalë është dhënë. Shembuj të kontributeve që janë të pavarur nga numri i viteve të shërbimit përfshijnë ato që janë një përqindje fikse e pagës së punonjësit, një shumë fikse përgjatë gjithë periudhës së shërbimit ose e pavarur nga mosha e punonjësit.

Paragrafi A1 jep udhëzimet përkatëse të zbatimit.

- 94 Për kontributet nga punonjësit ose nga palët e treta që janë atribuar periudhave të shërbimit në përputhje me paragrafin 93(a), n~~N~~dryshimet në kontributin e punonjësit ose palës së tretë në lidhje me shërbimin rezultojnë në:
- (a) kostot e tashme dhe të kaluara të shërbimit (në qoftë se këto ndryshime në kontributin e punonjësit nuk janë përcaktuar në termat formalë të skemës dhe nuk rrjedhin nga detyrime konstruktive); ose
- (b) fitime dhe humbje neto aktuariale (në qoftë se këto ndryshime në kontributin e punonjësve janë të përcaktuara në termat formalë të skemës, ose rrjedhin nga detyrime konstruktive).
- ...

### Dispozitat kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

- ...
- 175 Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësit (Ndryshime të SNK 19), publikuar në Nëntor 2013, paragrafët 93-94 të ndryshuar. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2014 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Lejohej zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## Ndryshime të Shtojcave të SNK 19 Përfitimet e punonjësve

Shtojca A është shtuar.

### Shtojca A Udhëzime të zbatimit

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e kësaj SNRF. Ajo përshkruan aplikimin e paragrafëve 92-93 dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të SNRF.*

A1 Kërkesat e kontabilitetit për kontributet nga punonjësit ose nga palët e treta janë ilustruar në diagramën e mëposhtme.

